

Hajrie Muçmata




GJYQTARE E GJYKATËS SË
APELIT SHKODËR

Deklaratat e analizuarat:

15 Deklarata të analizuarat

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri
Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Pasuria bruto nga fillimi detyrës deri me datë 31.12.2017 është rritur 6.6 herë

+ 1,528,895 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete
në Bankë




Likuiditete
në Cash



Pasuritë e
Luajtshme



Pasuritë e
Paluajtshme



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni	16,706,411	45.10%
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	11,227,507	30.31%
Të ardhura nga qeraja	2,475,500	6.68%
Dhurata në Cash	4,000,000	10.80%
Fitimi nga shitblerja e pasurive të paluajtshme	1,920,200	5.18%
Të ardhura të tjera	714,000	1.93%
Total	37,043,617	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

2 Me probleme
12 Pa Probleme



Subjekti Hajrie Muçmata rezultoi me burime të pamjaftueshme financiare në vitet 2004 dhe 2006; përkatësisht në shumën 2,632,420 lekë dhe 5,495,178 (në këtë analizë nuk janë llogaritur shpenzimet vjetore për konsum familjar).

Pasuria e pajustificuar në vitin 2004 lidhet me blerjen e një apartamenti banimi me çmim 33,000 euro, për të cilin mungon burimi financiar. Në vitin 2005 është deklaruar huamarrje me qëllim blerje apartamenti në shumën 18,000 euro pa interes dhe pa afat. Por meqenëse këto transaksione i përkasin periudhave të ndryshme, krijohen dyshime të arsyeshme mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie në vitin 2004.

Shtimi i pasurisë ndër vite ka si burim kryesor kreditë, huatë dhe dhuratat nga të afërmit, konkretisht: (i) në vitin 2005 bashkëshorti i subjektit deklaroi dhuratë nga prindërit në shumën 4,000,000 lekë; (ii) huamarrje për blerje apartamenti 18,000 euro dhe huamarrje për blerje garazhi 30,000 euro; (iii) kredi bankare 3,000,000 lekë.